



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Pradato Received/Delivered	04.02	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta e Prilog Appendix	Sasia Kohema Quantity	
SKPMSHCK	468/2021		114	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.04/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.04/2021 të datës 08.01.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati "Doganaj", Komuna e Ferizajt, kundër Vendimit me numër 01 Nr.01-203/2020 të datës 24.11.2020 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.02.2021, mori këtë

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.04/2021 e datës 08.01.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër 01 Nr.01-203/2020 i datës 24.11.2020 i Kryetarit të Komunës së Ferizajt.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Ferizajt, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën e Zyrtarit Ligjor në Drejtorinë e Urbanizimit në Komunën e Ferizajt, sipas Akt Emërimit të datës 28.06.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Kryetari i Komunës së Ferizajt, më datë 24.11.2020 përmes Vendimit me numër protokoll 01 Nr.01-203/2020 ka transferuar ankuesin nga pozita e punës "Zyrtar Ligjor" pran Drejtorisë së Urbanizmit, në pozitën e punës "Zyrtar për Lëshimin e Aktvendimeve" në Njësinë e Gjendjes Civile të Qytetit.

Kundër Vendimit me numër 01 Nr.01-203/2020 të datës 24.11.2020, ankuesi më datë 08.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 35/2021 të regjistruar me numër A.nr.04/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se vendimi për transferimin e tij është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 30.11.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Ferizajt. Këshilli më datë 10.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën numër protokoll 35/2021 të datës 08.01.2021 të regjistruar me numër A.nr.04/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për kërkesë apo ankesë e datës 30.11.2020; Vendimin me numër 01 Nr.01-203/2020 të datës 24.11.2020 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Ligjor; Akt Emërimit e datës 28.06.2019, si dhe përgjigjen në ankesë të datës 29.01.2021 nga Komuna e Ferizajt.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, të dorëzuara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Kolegji, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar me afat të paktuar në pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1" pran Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Ferizajt.

Me datë 24.11.2020, përmes Vendimit me numër 01 Nr.01-203/2020 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, ankuesi është transferuar nga pozita e punës "Zyrtar Ligjor" pran Drejtorisë së Urbanizmit, në pozitën e punës "Zyrtar për Lëshimin e Aktvendimeve" në Njësinë e Gjendjes Civile të Qytetit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Kryetarit të Komunës, me datë 08.01.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se Vendimi me numër 01 Nr.01-203/2020 i datës 24.11.2020 i Kryetarit të Komunës së Ferizajt është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, kështu që ankuesi ka kërkuar të anulohet Vendimi me numër 01 Nr.01-203/2020 i datës 24.11.2020 dhe të obligohet organi i punësimit që ta kthejë në pozitën e punës Zyrtar Ligjor pran Drejtorisë së Urbanizmit, sipas Akt Emërimit të datës 28.06.2019.


Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka analizuar legjislacionin në fuqi, dhe ka konstatuar se çështja e transferimit të nëpunësve civil është e rregulluar me dispozitat e nenit 52, 53 dhe 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Kolegji duke iu referuar pjesës hyrëse të Vendimit numër 01 Nr.01-203/2020 të datës 24.11.2020, ka gjetur se vendimi për transferimin e ankuesit nga pozita e punës "Zyrtar Ligjor" pran Drejtorisë së Urbanizmit, në pozitën e punës "Zyrtar për Lëshimin e Aktvendimeve" në Njësinë e Gjendjes Civile të Qytetit është nxjerr duke u bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e cila dispozite përcakton se nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve, mirëpo Kolegji ka konstatuar se organi i punësimit, në këtë rast Kryetari i Komunës së Ferizajt në arsyetim të vendit nuk ka dhënë asnjë arsyeje se cili ka qenë interesi i institucionit për të transferuar ankuesin në pozitën e Zyrtarit për Lëshimin e Aktvendimeve pran Njësisë së Gjendjes Civile të Qytetit, si dhe nuk e ka përcaktuar afatin sa do të zgjasë transferimi i nëpunësit civil, siç parashihet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 4 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52 paragrafin 3 të Ligjit.*

Kolegji, po ashtu, gjatë shqyrtimit të këtij rasti, ka konstatuar se Vendimi numër 01 Nr.01-203/2020 i datës 24.11.2020, nuk shpjegon situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe një gjë e tillë ia ka pamundësuar ankuesit që ta kuptojë aktin administrativ, gjegjësisht arsyen e transferimit të tij, kështu që Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, sepse Vendimi numër 01 Nr.01-203/2020 i datës 24.11.2020 është në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, si dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 si dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.04/2021

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Jeton KOÇA
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

